



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Powering new generations against extremism



## NJOFTIM PUBLIK

### Për zbatimin e projektit

#### “Shkollat si kundërshtarë të vijës së parë të ekstremizmit të dhunshëm”

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të rinjve (Observatori) në kuadër të skemës së granteve të vogla të projektit “*Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Rritjen e Reziliencës së të Rinjve ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm*” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Terre des Hommes Shqipëri në partneritet me ISD, CCG dhe Universitetin Beder po zbaton projektin me temë “**Shkollat si kundërshtarë të vijës së parë të ekstremizmit të dhunshëm**”. Kohëzgjatja e nismës është 10 muaj, Shkurt – Nëntor 2018. Ky projekt po zbatohet në 3 bashki dhe përkatësisht në Bashkinë Kamëz, Elbasan dhe Pogradec. Zonat pilot të zbatimit të projektit janë 3 shkolla të mesme; “Ibrahim Rugova” në Kamëz, “Mahmud Ali Cungu” në Elbasan dhe “Qemal Bazeli” në Çerravë - Pogradec. *Qëllimi kryesor i këtij projekti është parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm duke angazhuar shkollat si një institucion kryesor i vijës së frontit.*

Projekti do të zbatohet nëpërmjet realizimit të disa aktiviteteve ndër të cilat është edhe një paketë ku do të përfshihen disa tema për ekstremizmin e dhunshëm. Kjo paketë synohet të miratohet nga MASR dhe IZHA dhe të jetë pjesë e programit edukativ të nxënësve të shkollave të mesme të klasave të X dhe XI për vitet e ardhshme akademike. Aktivitete të tjera të projektit do të jenë si më poshtë:

- ✓ Ngritja e kapaciteteve të stafit të 3 shkollave pilot nëpërmjet realizimit të trajnimit të 60 mësuesve për një kuptim më të mirë të ekstremizmit të dhunshëm dhe angazhimit për parandalimin e tij.
- ✓ Realizimi i debateve publike mbi tolerancën me pjesmarrjen e nxënësve, mësuesve, prindërve, komunitetit, përfaqësues të institucioneve lokale dhe organizata të shoqërisë civile. Synimi i këtyre debateve, gjatë të cilëve do të jenë të ftuar lektorë nga institucione të ndryshme dhe të fushës, do të jetë formimi i konceptit kundër ekstremizmit të dhunshëm për 600 nxënës dhe pjestarë të komunitetit të zonave pilot.
- ✓ Realizimi i një fushate ndërgjegjëse publike. Gjatë kësaj fushate do të caktohet një ditë si “dita kundër dhunës” dhe do të inkurajohen vullnetarë të rinj për realizimin e saj. Në këtë ditë nxënësit e shkollave pilot do të nxiten të jenë pjesë e fushatës ndërgjegjëse duke promovuar tolerancën në rrugët e Kamzës, Elbasanit dhe Çerravës.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Powering new generations against extremism



---

Ky projekt do të rrisë kapacitetet e shkollës për t'u ballafaquar me ekstremizmin e dhunshëm dhe do të formësojë qëndrimet e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Aktivitetet kryesore të projektit do të bëhen publike gjatë gjithë kohës së zbatimit të tij në faqen e web-it të Observatorit: [www.observator.org.al](http://www.observator.org.al) dhe facebook: [Observatori për të Drejtat e Fëmijëve/Observatory for Children's Rights](https://www.facebook.com/Observatori-për-të-Drejtat-e-Fëmijëve-Observatory-for-Children's-Rights)

Për të gjithë që janë të interesuar të dinë më shumë për projektin që zbatohet nga Observatori mund të kontaktojnë në adresën e emaili-t: [z.kondi@observator.org.al](mailto:z.kondi@observator.org.al)

## Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Tiranë më, 15 Mars 2018

[#FuqizimiShoqërisëCivilënëRritjeneReziliencësSëtëRinjveNdajEkstremizmitTëDhunshëm#](https://twitter.com/FuqizimiShoqërisëCivilënëRritjeneReziliencësSëtëRinjveNdajEkstremizmitTëDhunshëm)